

TAKIMI I PARË 2023 - KOMITETI SEKTORIAL I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Mbledhja e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit u mbajt më datë **28.02.2023**.

Në vijim të diskutimeve në takimin e mëparshëm u shpjegua për anëtarët se kurrikula e profilit **“Inxhinieri Informatike Software-ike”** ishte një kurrikul austriake dhe se, me qëllim ruajtjen e të njëjtave tipare të krahasueshmërisë, gjatë rishikimit të kurrikulës ekzistuese, grupit të punës do t’i bashkohej një ekspert kurrikule nga Austria, në mënyrë që të mos humbiste krahasueshmëria dhe përshtatshmëria me shkollën austriake.

Anëtarët e Komitetit Sektorial u prezantuan me ofertën aktuale të kurseve afatshkurtra të ofruara nga Qendrat Rajonale të Formimit Profesional Publik (QRFPP) në nivel kombëtar.

U prezantuan kurset që ofrohen në QRFPP, përkatësisht: **“Aftësi digjitale”** (bazë/mesatare), **“Start smart”**, **“Teknik rrjeti kompjuterik”**, **“Web design”** dhe **“Graphic design”**, duke u sqaruar kriteret hyrëse për këto kurse, kohëzgjatja dhe objektivat e tyre. Sekretariati Teknik theksoi se, disa nga kurset e përmendura, shumë shpejt do të kishin kurrikulën e miratuar nga ministri përgjegjës për arsimin profesional, duke u shndërruar në kurse të unifikuara në nivel kombëtar. Përfaqësuesja e AKPA informoi pjesëmarrësit gjithashtu me informacion të mëtejshëm për kurset, si: numri i kursantëve, procedurat që ndiqen për punësimin e instruktorëve në kurse, si dhe synimet e kurseve.

Konkluzione dhe propozime:

- Kursi **“Aftësi digjitale”** të kishte një shtrirje më të gjerë dhe të ishte mundësia për t’u ndjekur online ose nëpërmjet video-ve tutoriale, për ti bërë lehtësisht të aksesueshme.
- Të zhvilloheshin kurse profesionale për disa pozicione koduese, si p.sh. **“Zhvillues në front end”** (si kodues dhe jo design).
- Të ofrohej një kurs profesional për **“Cyber Security”**, krahas kualifikimit pas të mesëm, me qëllim pajisjen e publikut të gjerë me aftësitë bazike për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë përdorimit të aplikacioneve, website-ve apo internetit në përgjithësi.
- Të zhvilloheshin fushata reklamimi dhe informimi publik me përfshirjen e njerëzve të duhur për të gjitha kurset profesionale, për të tërhequr masën e synuar drejt kësaj oferte.
- Të përgatiteshin dy kualifikime pas të mesme, me kohëzgjatje 1-vjeçare për: **“IT Support Specialist”** dhe **“Cyber Security”**.
- Për **“Front End Developer”** u dakordësua që të ofrohej si kurs i unifikuar dhe gjithashtu të shqyrtohej mundësia që “data entry” të ofrohet në formën e një kursi afatshkurtër.
- Ndryshimi i drejtimit **“Ekonomi - Biznes”** në **“Informatikë Ekonomike”** do të ndryshonte plotësisht identitetin e kualifikimit dhe nuk do të flitej më për ekonomi. Maksimumi që mund të realizohej në profilin **“Ekonomi - Biznes”** ishte shtimi i disa lëndëve të natyrës teknologjike financiare, si p.sh. marketing digjital, etj.